



Mali i Zi / Crna Gora
Komuna e Tuzit / Opština Tuzi
Sekretariati për vetëqeverisje lokale
Sekretarijat za lokalnu samoupravu
Nr./Br. 04-100/25-2879/4

shpallje me: 20.05.2025
Përzgjedhje me: 04.06.2025



Rruga Tuz nr. 1, nr. 44
Ulica Tuzi br.1, br. 44

+382 20 875 167

veteqeverisje.lokale@tuzi.org.me

Tuz – Tuzi, 20.05.2025. godine

Në bazë të nenit 113 paragrafit 1 dhe 3 të Ligjit mbi vetëqeverisjes lokale ("Fleta Zyrtare e MZ", nr. 02/18, 34/19, 038/20, 050/22, 084/22), e në lidhje me nenin 5 të Vendimit mbi organizimin mbi mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale", nr. 022/23, 024/23, 029/24, 032/24) dhe Vendimit mbi fillimin e procedurave për plotësimin e vendit të punës, numër 01-100/25-2879/3 prej më 12.05.2025, Sekretariati për vetëqeverisje lokale - Zyra për burimet njerëzore, sh p a ll

KONKURS TË BRENDSHËM

për nevojat e Shërbimit të kryetarit të Komunës së Tuzit

1. Referent/e i/e pavarur – Mbrojtës/e- Sektori për punë të përgjithshme- Shërbimi i krytarit

- Ekzekutues: 1, në kohë të pacaktuar
- Niveli i IV1 i kualifikimit të arsimit të mesëm të përgjithshëm ose profesional;
- së paku tri vite përvojë pune;
- provimi profesional për punë në organet shtetërore;
- provimi profesional për kryerjen e punëve mbrojtse;
- njohja e gjuhës shqipe;
- njohja e punës në kompjuter.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- formulari i paraqitjes për vendin e lire të punës (Formularin e paraqitjes për vendin e lirë të punës kandidatët mund ta nxjerrin në web faqen e Komunës së Tuzit www.tuzi.org.me ose drejtpërdrejt në arkivin e Komunës së Tuzit),
- Curriculum Vitae – CV,
- fotokopja e letërnjoftimit biometrik e vërtetuar,
- diplomë ose vërtetim mbi përfundimin e nivelit dhe llojit të arsimit të vërtetuar;
- vërtetimin se nuk është denuar për vepër penale që e bën të papërshtatshëm për të punuar në organet shtetërore, e siguron organi sipas detyrës zyrtare;
- dëshmi (vërtetim/miratim) mbi përvojën e kërkuar të punës të vërtetuar,
- vërtetim mbi provimin e dhënë profesional për punë në organet shtetërore të vërtetuar,
- vërtetim mbi provimin e dhënë profesional për punë mbrojtse.

Kandidatët janë të detyruar që Zyrës për burimet njerëzore (në tekstin e mëtejshëm: Zyrja), të dorëzojnë me formularin e paraqitjes origjinal dokumentacionin ose fotokopjet e vërtetuara të dokumentacionit.

Në konkurs të brendshëm mund të paraqitet zyrtari lokal i cili ka lidh marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, inspektori kryesorë dhe personi zyrtarë kryesorë i autorizuar, personi nga neni 128 paragrafi 2 i Ligjit mbi vetëqeverisje lokale ("Fleta zyrtare e MZ", nr.02/18, 34/19, 38/20, 050/22, 084/22) si dhe personi të cilit i ka pushuar mandati me skadimin e mandatit, në kërkesë personale, me shkëputjen e organit të administratës lokale, shërbimit profesional, gjegjësisht shërbimit të veçantë ose pjesës së punëve që nuk ndërmerr organi tjetër ose shërbimi ose nëse

vendi i punës së tij do të ndërpritet me sjelljen e aktit të ri ose ndryshimin e atij ekzistues mbi sistematizimin dhe organizimin e brendshëm.

Me organin shtetëror nuk mund të lidh vend pune personi i cili është përdorues i të drejtës në pension, në pajtim me ligjin.

Zyrtari lokal i cili është në punë të provës nuk ka të drejtë të paraqitet në konkurs të brendshëm.

Verifikimi i dijes, aftësisë, kompetencave dhe shkathtësive, varësisht prej kategorisë së vendit të punës do të bëhet në pajtim me nenin 115 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta Zyrtare e MZ", numër 02/18, 34/19, 38/20, 050/22, 084/22) dhe me Rregullore për kriteret dhe metodën më të afërt të kryerjes së vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave dhe aftësive për të punuar në organet shtetërore ("Fleta Zyrtare e MZ", numër 50/18).

Testimi në formë të shkruar përbëhet nga pjesa teorike dhe ajo praktike dhe nënkupton hartimin e testit të shkruar.

Verifikimi i dijes së daktilografisë, informatikës ose gjuhës së huaj bëhet në pajtim me rregullat, gjegjësisht standardet në këto fusha.

Testi i shkruar hartohet në formë elektronike, me shifër.

Mbi datën, vendin, dhe mënyrën e verifikimit, të kandidatëve nga lista, kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e shpalljes publike do të jenë të njoftuar përmes ueb faqes së Komunës së Tuzit, më së largu pesë ditë para ditës së verifikimit.

Dokumentacioni i kërkuar është i nevojshëm të dorëzohet në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit të brendshëm në zarf të mbyllur (në të cilin është e nevojshme të shkruhet: emri dhe mbiemri, adresa, kontakt telefoni, emri i organit dhe vendi i punës) në adresën:

Komuna e Tuzit

Sekretariati për vetëqeverisje lokale - Zyra për burime njerëzore

Me shënim: për Konkurs të brendshëm për nevoja të Sherbimit të kryetarit të Komunës së Tuzit

Kontakt tel: +38220875167;

